

VENDIM
Nr. 174, datë 29.12.2016

**PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. ELVIS ROSHI, KRYETAR I
BASHKISË KAVAJË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, “PËR GARANTIMIN E
INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 29.12.2016, me pjesëmarrjen e:

Denar Biba	kryetar;
Hysen Osmanaj	zëvendëskryetar;
Bledar Skënderi	anëtar;
Edlira Jorgaqi	anëtare;
Gëzim Veleshnja	anëtar;
Klement Zguri	anëtar;
Vera Shtjefni	anëtare.

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Elvis Rosh, kryetar i Bashkisë Kavajë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, neni 15, pika 3, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pikat 12, 13, 14 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, neni 14, neni 15, pika 3 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pika 12, 13, 14 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Kavajë z. Elvis Rosh.
2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit, për të vijuar me procedurat parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Denar Biba